

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

BNT ELECTRONICS

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J61817047D

NUIS/NIPT

Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0684040505

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

financa@bntelectronics.com

E-mail

Administrator Kristi Bojdani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2025/07/16

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0684040505

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-53715-07-07-2025

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

12427695

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Loti 49 - Shërbim mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Toshiba /ose ekuivalent

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2025/08/07

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Shërbime

Data e zhvillimit të procedurës

2025/08/07

Numri i njoftimit

CN/66737/07072025

Kodi CPV

50000000-5 - Shërbime mirëmbajtje dhe ripar

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

Neni 109 e në vijim i LPP, hartimi i kriterëve diskriminues dhe jo në përputhje me ligjin dhe vkm për rregullat e prokurimit publik,

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit

☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

☐

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Te nderuar

Ne datën 08.07.2025 ne Sistemin e Prokurimit Elektronik është publikuar procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtjen Full Risk për një periudhë 24 muajore të pajisjeve të vogla mjekësore të QSUNT” e ndarë në 67 lote, Loti 49 - Shërbim mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Toshiba /ose ekuivalent”, me fond limit 12,427,695.20 Lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 07.08.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

Pasi u njohëm me dokumentat standard të tenderit, konstatuam se në këto DST të publikuara për këtë procedurë prokurimi kriteret nuk janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Referuar nenit 110 të LPP 162/2020 i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”, shoqëria jonë “BNT Electronics” shpk paraqet më poshtë ankesën tonë në përputhje me nenin 109 e në vijim të LPP.

Shoqëria jonë ka interes prima face në këtë procedurë prokurimi, jemi brenda afateve ligjore për të paraqitur ankesën, pasi procedura është publikuar në datën 08.07.2025 dhe sot në datë 16.07.2025 brenda afatit 10 ditor nga dita e shpalljes së kësaj procedure prokurimi, po paraqesim këtë ankesë dhe si të tillë legjitohemi për të paraqitur ankesën tonë për këtë procedurë prokurimi

Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, më poshtë po paraqesim kundërshtimet tona, lidhur me përcaktimin e kriterëve për kualifikim nga AK në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në fuqi.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Si më sipër shpjegojmë rrethanat e faktit, do të vijojmë të argumentojmë pretendimet dhe qëndrimin tonë lidhur me hartimin e dokumentave të tenderit nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë

1. Konkretisht, në Shtojcën 9, në pikën 2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë, gërma “c” AK ka përcaktuar kriterin e mëposhtëm:

c) OE duhet të jetë i autorizuar nga MSHMS për tregëtim të pajisjeve mjekësore.

Sqarojmë se, në nenin 2 të LPP parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

Ndërsa në nenin 3 të tij janë parashikuar parimet e përgjithshme konkretisht si më poshtë:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

Në nenin 21 të LPP parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Ndërsa në nenin 77/1/4 të LPP përcaktohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Në nenin 40/3 të VKM 285/2021 të ndryshuar, parashikohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit

duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentat konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë AK për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë që në bazë të dokumentacionit që do të paraqesin në një procedurë prokurimi duhet të vërtetojnë që zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe stafin dhe personelin e nevojshëm gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. AK harton dokumentat e tenderit në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, por kjo gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës, objektit të saj, volumit dhe natyrës, AK përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga AK duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Referuar bazës ligjore si më sipër cituar, gjykojmë se duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës, me qëllim mbajtjen në konsideratë të parimeve si mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve, transparenca në procedurat e prokurimit, barazia në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, e mbi këto parime kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse, si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik dhe jo të bëhen pengesë e të shkojnë drejt kufizimit të pjesëmarrjes dhe pengesës së mundësive për të marrë pjesë operatorë ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

Sa i takon kërkesës së përcaktuar nga AK lidhur me Autorizimin e MSHMS për tregëtim të pajisjeve mjekësore, referuar objektit të prokurimit dhe volumit të kontratës objekt prokurimi, për më tepër objektit të prokurimit gjykojmë se kjo kërkesë e AK është konfuze dhe jo në përputhje me volumin dhe objektin e kontratës.

Sqarojmë se dokumentat e tenderit në këtë rast janë dokumenta për shërbim pasi objekti i prokurimit është mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore dhe kërkesa e AK për autorizim nga MSHMS për tregëtim të pajisjeve bie ndesh me këtë objekt prokurimi, pasi në këtë rast nuk kemi kontratë blerje malli por shërbim mirëmbajtje.

Referuar Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të mbajtur nga AK në datë 07.07.2025, konstatojmë se lidhur me këtë kriter është cituar vendosja e tij për arsyet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020"Per Prokurimin Publik", në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të

ofertuesit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive”.

Duke vijuar me arsyetimin e mësipërm, kundërshtojmë vendosjen e këtij kriteri për më tepër se edhe vetë AK nuk ka dhënë asnjë argument mbi këtë kriter, pasi kërkesa për Autorizim nga MSHMS për tregëtim të pajisjeve nuk ka të bëjë me çertifikatat e cilësisë dhe nuk ka lidhje as me nenin 77 të LPP e 41 të VKM dhe as me rekomandimin e përbashkët APP dhe DPA pasi ky rekomandim ka të bëjë me çertifikatat e cilësisë dhe jo autorizimin përkatës të kërkuar nga AK.

Gjykojmë se kjo kërkesë është kufizuese, ul konkurrencën dhe për më tepër nuk është në proporcion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, e cila është objekt shërbimi mirëmbajtje dhe jo blerje malli/pajisje mjekësore për të cilat mund të kërkohej një autorizim i tillë për tregëtimin e tyre.

Sa më sipër, kërkojmë modifikimin e dokumentave të tenderit duke u hequr ky kriter.

2. Në Shtojcën 9, në pikën 2.3/a Kapaciteti Teknik, AK ka përcaktuar kriterin e mëposhtëm:

” a) Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohej vërtetime* të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen shërbimet.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilën ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në pikën 2.10 / 2.14.

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, 20% do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Pra në këtë pikë është kërkuar që në rastin e dëshmimeve të mëparshme me një ent publik, OE pjesëmarrës do të duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik së bashku me kontratën përkatëse.

Ashtu si edhe më sipër, theksojmë që kriteret për kualifikim vendosen nga AK dhe i shërbejnë atij për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë që në bazë të dokumentacionit që do të paraqesin në një procedurë prokurimi duhet të vërtetojnë që zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe stafin dhe personelin e nevojshëm gjithëcka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. AK harton dokumentat e tenderit në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për

kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, por kjo gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës, objektit të saj, volumit dhe natyrës, AK përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga AK duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në rastin konkret DST janë dokumenta shërbimi pasi kemi të bëjmë me një kontratë shërbimi pasi është mirëmbajtje e pajisjeve, si dhe vetë AK e ka përcaktuar në DST që është shërbim ky objekt prokurimi.

Në nenin 41/2/3 të VKM 285/2021 të ndryshuar, parashikohet se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.

Legjislacioni në fuqi në rastin e përvojës së mëparshme me një ent publik, ka përcaktuar që duhet të kërkojnë vërtetime realizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes.

Në këtë rast AK nuk mund të kërkojë dokumentacion më shumë se sa është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, i cil ka krijuar lehtësira për operatorët ekonomikë, për më tepër që AK e mer informacionin e duhur nga vërtetimi i realizimit ose/dhe faturat tatimore, si edhe është dokumentacion lehtësisht i verifikueshëm prej tij.

Sa më lart, AK nuk mund të kërkojë dokumenta jashtë kriterëve dhe përcaktimeve të bëra në LPP dhe VKM 285/2021, të cilat nuk janë në proporcion me objektin dhe natyrën e objekti të prokurimit.

Edhe në Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të mbajtur nga AK në datë 07.07.2025, konstatohet se lidhur me këtë kriter është cituar vendosja e tij bazuar në nenin 77/4 të LPP dhe nenin 41/3 të VKM 285/2021, por duke mos argumentuar faktin se pse janë kërkuar përveç vërtetimit të realizimit edhe kontratat kur vetë neni 41/3 i cituar, parashikon në rastin e kontratave të lidhura me ent publik vetëm vërtetim realizimi ose / dhe fatura tatimore.

Sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, me

qëllim moskufizimin e konkurrencës dhe diskriminimin e operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

3. Në Shtojcën 9, në pikën 2.3/b Kapaciteti Teknik, AK ka përcaktuar kriterin e mëposhtëm

b) Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 2(dy)* Inxhinierë/Specialistë në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, çertifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.

*Shënim: Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).

*Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomikë do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Ashtu si edhe më sipër, theksojmë që kriteret për kualifikim vendosen nga AK dhe i shërbejnë atij për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë që në bazë të dokumentacionit që do të paraqesin në një procedurë prokurimi duhet të vërtetojnë që zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe stafin dhe personelin e nevojshëm gjithëkrah në funksion të realizimit me sukses të kontratës. AK harton dokumentat e tenderit në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, por kjo gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës, objektit të saj, volumit dhe natyrës, AK përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga AK duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kriter AK ka vendosur kërkesa diskriminuese dhe jo në përputhje me natyrën dhe objektin e kësaj procedure prokurimi.

AK në hartimin e kriterëve për kualifikim duhet të mbajë në konsideratë parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe kriteret duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

- Së pari lidhur me kërkesën e AK për disponueshmërinë e të paktën 2 (dy) inxhinierë/specialistë në stafin e vet, referuar objektin, natyrës dhe vlerës së prokurimit të kësaj procedure gjykojmë se nuk është në përputhje me volumin e objektit dhe është kufizuese pasi edhe një specialist/inxhinier do të ishte e mjaftueshme për të kryer këtë procedurë prokurimi duke iu referuar edhe volumit të pajisjeve, që janë për këtë lot, për më tepër që thjesht shërbim mirëmbajtje është dhe është e mjaftueshme kërkesa edhe vetëm për 1 (një) punonjës të tillë.

Sa më sipër AK duhet të modifikojë këtë kriter duke ulur numrin e specialistëve të kërkuar pasi shërbimi i mirëmbajtjes për këto pajisje mund të kryhet më së miri edhe nga një inxhinier/specialist i tillë.

Madje Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në vendimmarrjet e tij lidhur me kritere të tilla ka mbajtur qëndrim që në procedura të tilla kritere të tilla janë konsideruar

diskriminuese dhe duhet të hiqen.

Konkretisht në Vendimin Nr. 1228/2024, datë 10.09.2024, me Nr. 1845/5 Prot, KPP ka vendosur heqjen e këtij kriteri (bashkëlidhur vendimi KPP, pjesa III.3 e pjesës Arsyeton).

- Së dyti, në këtë kriter është përcaktuar që: paktën 2(dy)* Inxhinierë/Specialistë në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit.

Ky kriter është diskriminues dhe jo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi.

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomike të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e aseteve të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithashtu në funksion të realizimit të suksesshëm të kontratës.

Autoriteti kontraktor harton dokumentat e tenderit në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi ndaj edhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje me përpjesëtimin me natyrën dhe objektin e kontratës së prokurimit.

Në varësi të kontratës, volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë të interesuar për atë procedurë prokurimi.

Vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporzion me objektin e prokurimit dhe në fokusin e realizimit të suksesshëm të kontratës.

Referuar parimeve të përcaktuara në ligjin për prokurimin publik, si mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë i kandidatëve ose ofertuesve, transparencë, barazi etj, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse, si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik dhe LPP.

Referuar objektit dhe volumit të kontratës objekt prokurimi, karakteristikave të shërbimit që do të kryhet gjykojmë se kjo kërkesë e autoritetit kontraktor për staf të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, është kufizuese si dhe jo në përputhje me volumin, natyrën dhe objektin e prokurimit.

Madje Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në vendimmarrjet e tij lidhur me kriteret të tilla ka mbajtur qëndrim që në procedura të tilla kriteret të tilla janë konsideruar diskriminuese dhe duhet të hiqen.

Konkretisht në Vendimin Nr. 1228/2024, datë 10.09.2024, me Nr. 1845/5 Prot, KPP ka vendosur heqjen e këtij kriteri (bashkëlidhur vendimi KPP, pjesa III.3 e pjesës Arsyeton).

Nga ana tjetër duam të sjellim në vëmendje se në ligjin për prokurimin publik jo pa qëllim është përcaktuar ndër të tjera kuptimi i fjalës “Ekuivalente” në nenin 7/4 të LPP 162/2020.

Konkretisht në këtë nen është përcaktuar se:

“Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë

përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit”.

Edhe në nenin 36 të LPP është përcaktuar se, çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët ose “ekuivalenti i tij/saj”.

Nisur nga kjo, AK në këtë kriter ka kufizuar dhe penguar pjesëmarrjen e shoqërive të interesuara për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, pasi kërkon në mënyrë eksplicite punonjës të trajnuar dhe çertifikuar vetëm për pajisjen mjekësorë për të cilën do të kryhet shërbimi pra në rastin konkret punonjës të çertifikuar vetëm për pajisjen prodhues Toshiba, duke ngushtuar në mënyrë artificiale konkurrencën me qëllim favorizimin ose dëmtimin në mënyrë të padrejtë të operatorëve ekonomikë që kanë experencë në këtë fushë dhe janë të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

Edhe Agjencia e Prokurimit Publik në rekomandimet e saj në rastet kur kemi të bëjmë me karakteristika të një malli apo shërbimi sugjeron që në përputhje me legjislacionin në fuqi, AK gjatë hartimit të DST duhet të mbajë në konsideratë si edhe të përdorë fjalën “Ekuivalent” në rast të tilla me qëllim hapjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjen e një numri të gjerë operatorësh ekonomikë (Rekomandim Nr. 3341/1 Prot., datë 20.03.2018).

Ndërkohë vetë AK në hartimin e dokumentave të tenderit që në objektin e kësaj procedure prokurimi / objektin e këtij loti e ka titulluar atë:

Loti 49 - Shërbim mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Toshiba /ose ekuivalent.

Pra vetë AK me të drejtë e ka përcaktuar mirëmbajtje të pajisjes së prodhuesit Toshiba / ose ekuivalent dhe në këtë frymë duhet të hartoheshin edhe kriteret për kualifikim dhe DST.

Në këtë rast gjykojmë se përcaktimit të këtij kriteri duhet t’i shtohet fjala “ose ekuivalent”, pra duke përcaktuar që stafi të jetë i trajnuar për pajisjet mjekësore për të cilat do të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizimin e vendosjes së pjesëve të këmbimit/ose ekuivalent.

Edhe në Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të mbajtur nga AK në datë 07.07.2025, konstatojmë se lidhur me këtë kriter është cituar se vendosja e tij është bazuar në nenin 77/4 të LPP dhe nenin 41/3 të VKM 285/2021 dhe se ky kriter është vendosur në mënyrë që e gjithë procedura të bëhet nga persona të kualifikuar të cilët garantojnë zbatimin e kontratës plotësisht dhe në mënyrën e duhur, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, por duke mos argumentuar faktin se pse janë kërkuar 2 punonjës dhe pse të jenë të trajnuar për pajisjet mjekësore për të cilat do të kryhet mirëmbajtja, kur ndërkohë vetë legjislacioni në fuqi si më sipër argumentuam parashikon që nr i punonjësve duhet të jetë në proporcion me natyrën dhe vlerën e objektit e prokurimit, si edhe parashikon edhe termin ekuivalent kur kemi të bëjmë me përcaktime emrash pajisje, prodhuesi etj.

Sa më sipër, AK duhet të heqë një kriter të përcaktuar në mënyrë të tillë ose duhet të përcaktojë termin ekuivalent me qëllim moskufizimin e konkurrencës dhe shmangien e kriterëve të tilla diskriminuese dhe jo në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

4. Gjithashtu në Shtojcën 9, në pikën 2.3 Kapaciteti Teknik, gërma “c”, AK ka përcaktuar kriterin e mëposhtëm

“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes Autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të jete original ose kopje e

perkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshem ne momentin e hapjes se ofertave”.

Ky kriter është diskriminues dhe jo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi.

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomike të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sikurse theksuam edhe më lart, AK është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të vecanta për kualifikim është në diskrecionin e AK por të gjitha këto kërkesa duhet të kenë lidhje dhe të jenë në proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës, bazuar kjo në nenin 7 të LPP.

AK në hartimin dhe vendosjen e kriterëve për kualifikim duhet të garantojë respektimin e parimeve të përcaktuara në LPP si atë të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe shmangien e kufizimit të konkurrencës por zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në përputhje me përcaktimet e nenit 2 të LPP.

Në dokumentet e tenderit është parashikuar si kriter kualifikimi që operatori ekonomik të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese e pajisjeve ose nga distributori i saj i autorizuar.

Sipas mendimit tonë, ky kriter nuk është në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës që ka për objekt mirëmbajtjen e pajisjeve, dhe jo furnizimin apo tregtimin e tyre.

Duke qenë se nuk kemi të bëjmë me një kontratë për furnizim mallrash (blerje pajisjesh), por me një kontratë shërbimi, kërkesa për autorizim nga prodhuesi apo distributori nuk është thelbësore për realizimin me cilësi të shërbimit të mirëmbajtjes. Prandaj, ky kriter konsiderohet i pajustifikuar dhe kufizues, pasi nuk lejon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që zotërojnë eksperiencën dhe kapacitetin teknik për të ofruar shërbimin, pasi për AK e rëndësishme është të arrihet shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjes, në kushtet kur sic theksuam edhe më lart, procedura e prokurimit është mirëmbajtje dhe jo blerje malli që të kërkohet autorizim prodhuesi për të.

Në këtë mënyrë, kriteri në fjalë bie ndesh me parimet e konkurrencës së lirë, barazisë në trajtim dhe proporcionalitetit, të parashikuara në nenin 2 të ligjit nr. 162/2020 Për prokurimin publik, si dhe është në kundërshtim me praktikën e qëndrueshme të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP).

Në mbështetje të qëndrimit të mësipërm, i referohemi Vendimit nr. 1228/2024, datë 10.09.2024, me nr. prot. 1845/5, ku KPP ka vlerësuar se kriteri për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi për procedura që kanë për objekt shërbime mirëmbajtjeje është diskriminues dhe në kundërshtim me frymën e ligjit, duke urdhëruar heqjen e tij nga dokumentet e tenderit (shih pjesa III.10 e arsyetimit të vendimit, bashkëlidhur për referencë).

Gjykojmë se kërkesa për të paraqitur Autorizim Prodhuesi apo nga Distributori është tërësisht e tepërt, që nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë me objektin e kontratës dhe për më tepër në tejkalim të nevojës për të garantuar realizimin e kësaj kontrate.

Në këtë rast, kërkesa mbi paraqitjen e autorizimit të prodhuesit kufizon konkurrencën duke bërë të mundur që në këtë procedurë të marrin pjesë një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë, në kundërshtim me frymën e LPP dhe RrPP ku kërkohet që në procedurat e prokurimit të stimulohet pjesëmarrja e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Në Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të mbajtur nga AK në datë 07.07.2025, konstatohet se lidhur me këtë kriter është cituar se vendosja e tij është bazuar në nenin 77/2/4 të LPP dhe nenin 41/3 të VKM 285/2021 dhe se “Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit

është një dokumenti domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (ref. Vendimit të KPP nr. 353/2014). Ky kriter u mbështet edhe në Rekomandimin nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik)".

Konkretisht AK nuk ka argumentuar dhe dhënë arsyet e këtij kriteri por thjesht i është referuar Vendimit të KPP dhe Rekomandimit të APP si më sipër cituar.

Lidhur me vendimin e KPP të cituar nga AK në procesverbalin e argumentimit të kriterëve, duam të ndalemi në dy momente:

1. Sqarojmë se ankesa në këtë rast për këtë procedurë që ka publikuar AK ka të bëjë me procedurë shërbimi dhe konkretisht procedurë mirëmbajtje pajisjesh dhe jo procedure blerje mallrash në të cilat AK mund të percaktojë një kriter të tillë gjithnjë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën dhe vlerën e tij.
2. Së dyti, vendimi KPP të cilin ju citoni (353/2014) është i një periudhe shumë të hershme dhe pavarësisht vendimmarrjes së qëndrueshme të KPP ndër vite, legjislacioni për prokurimin publik ka pësuar ndryshime thelbësore dhe e gjithë baza ligjore në periudhën kur është dhënë ky vendim është shfuqizuar dhe si i tillë nuk mund të merret për bazë dhe nuk mund të përdoret për efekt krahasimi.
3. Ndërkohë duam të sjellim në vëmendje vendimin e KPP nr. 1228/2024, datë 10.09.2024, me nr. prot. 1845/5, të cituar nga ana jonë në arsyetim, i cili ka shqyrtuar ankesat për kriter për procedurë prokurimi shërbimi siç është edhe kjo procedurë e publikuar nga ana AK, ku KPP ka vlerësuar se kriteri për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi për procedura që kanë për objekt shërbime mirëmbajtjeje është diskriminues dhe në kundërshtim me frymën e ligjit, duke urdhëruar heqjen e tij nga dokumentet e tenderit (shih pjesa III.10 e arsyetimit të vendimit, bashkëlidhur për referencë).

Gjithashtu, edhe vetë AK në procesverbalin e argumentimit të vendosjes së kriterëve për kualifikim, ka cituar se, ky është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues, pra edhe vetë AK ka ngatërruar rastin e procedurës së prokurimit pasi në këtë rast ashtu siç edhe KPP shprehet në vendimin 1228/2024, datë 10.09.2024, me nr. prot. 1845/5, kemi të bëjmë me procedurë shërbimi dhe jo blerje, pra AK kërkon shërbim mirëmbajtje dhe jo blerje të pajisjeve mjekësore.

Sa me sipër, edhe vete argumentimi i AK nuk qëndron dhe bie ndesh me parashikimet ligjore në fuqi, pasi si arsyetim për vendosjen e këtij kriteri AK citon se ky kriter i shërben AK për të siguruar se operatori ekonomik do të furnizojë produkte, ndërkohë që nuk kemi të bëjmë me furnizim malli, sic e thame edhe më lart, por me shërbim mirëmbajtje pajisje dhe një kërkesë e tillë nuk është e domosdoshme për një procedurë të tillë.

Ndërsa sa i takon Rekomandimit të APP nr. 3341/1 Prot., datë 20.03.2018 të cilës i referohet sërisht AK në citimin në PV e argumentimit të kriterëve për kualifikim, sqarojmë se në këtë rekomandim APP ka rekomanduar AK që në rastin kur në disa procedura prokurimi për furnizime AK e kërkojnë si kriter autorizimin e prodhuesit, duhet të përcaktojnë edhe mundësinë e paraqitjes së autorizimit nga distributor, pra së pari APP flet për procedura prokurimi blerje (siç argumentuar më

lart edhe vendimin e KPP) si edhe për të lënë mundësinë e autorizimit nga distributor në ato raste kur AK e ka kërkuar dhe argumentuar se pse e ka vendosur.

Pra APP nuk rekomandon vendosjen e kriterit për Autorizim Prodhuksi siç citon AK në PV e argumentimit të kriterëve për kualifikim, por të saktësohet në rastet kur AK e ka kërkuar në rastet e procedurave të prokurimit për blerje malli dhe jo shërbimi siç është rasti i procedurës së prokurimit të publikuar nga QSU.

Sa më sipër të dyja referencat e cituara nga AK në PV e argumentimit të kriterëve për kualifikim nuk qëndrojnë dhe nuk kanë të bëjnë me rastin në fjalë, ndërkohë që, vetë legjislacioni në fuqi si më sipër argumentuar parashikon që AK në vendosjen e kriterëve për kualifikim duhet të mbajë në konsideratë që ato duhet të lidhen me objektin e prokurimit në fjalë dhe të jenë në proporcion me natyrën dhe vlerën e objektin e prokurimit.

Për rrjedhojë, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor të bëjë rishikimin dhe heqjen e këtij kriteri, duke garantuar një proces prokurimi më gjithëpërfshirës dhe në përputhje me praktikën e KPP-së dhe legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër kërkojmë heqjen e këtij kriteri si një kërkesë jo në përputhje me objektin dhe natyrën e prokurimit.

Sa më sipër AK duhet të bëjë heqjen e kriterëve diskriminues dhe jo në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi.

- Nga ana tjetër, përveç faktit që ky kriter duhet të hiqet pasi është diskriminues dhe jo në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në fuqi, AK duket qartazi që në hartimin e kriterëve nuk ka mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore në fuqi.

Konkretisht, AK ka përcaktuar ndër të tjera që Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.

Pra AK përveç faktit që ka përcaktuar një kriter që nuk duhet të kërkohej, nga ana tjetër edhe vetë brenda këtij kriteri që në gjykimin tonë është kufizues dhe diskriminues, AK ka përcaktuar që ky dokument duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar.

Në dokumentat e tenderit AK ka përcaktuar që

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip	X	Anglisht	X
-------	---	----------	---

Në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, si edhe në DST Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, është e përcaktuar Gjuha e ofertës, ku citohet se: “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës?.. Në procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze”.

Nga ana tjetër, sqarojmë se me ndryshimet ligjore të bëra me VKM nr. 498, datë 01.08.2024, është ndryshuar neni 24 i VKM 285/2021, ku është përcaktuar si më poshtë vijon:

“Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të

hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht”.

Pra në këtë rast, ashtu sic shprehet në legjislacionin e prokurimit publik në fuqi edhe me ndryshimet më të fundit është përcaktuar që në procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë AK përcakton të dyja gjuhët dhe një ofertë kualifikohet edhe nëse një operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit do të paraqesë një pjesë të dokumentacionit në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.

Sa më sipër duhet të hiqet përcaktimi i përkthimit në gjuhën shqip dhe noterizimit, përse kohë që AK në shtojcën e publikuar ka përcaktuar se gjuhët e ofertës janë të dyja Shqip dhe Anglisht dhe në legjislacionin në fuqi me ndryshimet e fundit është përcaktuar paraqitja e dokumentacionit në të dyja gjuhët për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar sikurse është kjo procedurë prokurimi, duke evituar mospërputhjet dhe paqartësitë që mund të lindin në vijim të procedurës së prokurimit, gjatë hartimit të ofertave nga operatorët ekonomikë të interesuar.

Në përfundim kërkojmë modifikimin e kriterëve për kualifikim si më sipër argumentuar duke hequr kriteret diskriminuese dhe që pengojnë dhe ulin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar dhe duke përcaktuar ato në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☐

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

jo

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

I gjithë dokumentacioni i shoqerise

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. □

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

financa@bntelectronics.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Kristi Bojdani